

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 624 Prot.

Tiranë, më 10.052017

VENDIM Nr. 63, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë "Sondazhe kontrolli në vendbanimin prehistorik të Maliqit"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Adem Bunguri, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë "Sondazhe kontrolli në vendbanimin prehistorik të Maliqit"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Adem Bunguri, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Kontrollin dhe verifikimin e statigrafisë së Eneolitit.
 - Marrjen e mostrave të dheut nga shtresa kulturore e Eneolitit për analiza C₁₄
 - Marrjen e mostrave të dheut me mbetje bimore për kryerjen e analizave archeobotanike të çerealeve (carbonised seeds)
 - Kryerja e analizave në Gjermani
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë periudha kohore e nevojëshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTER



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO